



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**  
**Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda::**“ Mbi miratimin e listës së familjeve qe përfitojnë bonus qiraje për vitin 2026

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Propozimi në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

. Kusht për përfitimin e fondit të bonusit të qirasë nga buxheti i shtetit është që familjet që do të trajtohen me bonus qiraje, duhet të mbulojnë pjesën e mbetur të qerasë me të ardhurat e tyre ,ose nëpërmjet financimit të bashkisë

**Situata financiare**

Bashkia Berat ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit si dhe në zbatim të pikës 34,45 nenit 2, neni 33,34 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social ” i ndryshuar , vkm nr.459,datë 3.07.2019 “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, për qytetarët në nevojë për t’u strehuar , sipas formatit të kërkuar nga ministria përgjegjëse për strehimin, shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përfituese .

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave,Transportit dhe Mjedisit .

### **Impakti social / grupet që preken:**

Qytetarët në nevojë që mbushin kriteret e legjislacionit.

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 30 /01/2026,ora 09:00, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e listës së familjeve qe përfitojnë bonus qiraje për vitin 2026”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash:

### **VENDOSI**

1. Miratimin e listës për 63 familje të pastreha që përfitojnë bonus qiraje për vitin 2026 në vlerën 4,810,978 ( katërmiljon e tetëqind e dhjetmijë e nëntëqind e shtadhjet e tetë) lekë , sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi .
2. Vlera e bonusit të qirasë do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i bashkisë dhe do të filloj për çdo familje sipas afatit të kontratës së qirase .

### **Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**

**Krenar Suku- Kryetar i Komisionit**

**Anisa Veliu –N/Kryetar**

**Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit**

**Fatjon Elezi-Anëtar**

**Rovena Cuku-Anëtar**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Muharem Hoxha-Anëtar**

**Shyqyri Dura-Anëtar**

Datë 30 /01/2026